



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 30.09.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1296_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081),
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 31.08.2020 për derogim të Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit,

në seancën e mbajtur me datë 30.09.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET kërkesa e KOSTT SH.A. për Derogim të Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit.**

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 31.08.2020 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derogim për përpilimin e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit.

Në bazë të dispozitave ligjore dhe rregullative kërkohet që deri më 31 tetor çdo dy vite të përgatiten dokumentet Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike dhe Plani i Adekuacisë së Gjenerimit për 10 vitet vijuese.

Ndër dokumentet bazë për përpilimin e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit është Strategjia e Energjisë, dhe aktualisht në fuqi është Strategjia e Energjisë 2017-2026. Meqenëse rishikimi i Strategjisë së Energjisë nuk është bërë në këtë vit, dhe është formuar ekipi punues i cili pritet që gjatë vitit 2021 të përgatitë Strategjinë e Energjisë 2021-2030, e cila pritet të aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, andaj për të qenë në harmoni me Strategjinë e rishikuar, KOSTT ka kërkuar që edhe përgatitja e dokumenteve Bilanci Afatgjatë i



Energjisë Elektrike dhe Planit i Adekuacisë së Gjenerimit të shtyhen për një vit.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së KOSTT për derogim të përgatitjes së Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së,


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Selifaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi për derogim të Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit duhet të iu dërgohet palëve:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.